

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Inspektor, Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit, Sektori i Inspektimit (Kategoria III-b).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Inspektori ka detyra si më poshtë:

Inspektori varet nga Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit.

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
2. Realizon kontrollin në territorin e Bashkisë Tiranë në lidhje me situatën ndërtimore.
3. Inspekton në mënyrë të vazhdueshme objektet me leje ndërtimi sipas përcaktimeve nga Drejtori i Drejtorisë dhe Kryeinspektori.
4. Mban Procesverbal të Konstatimit mbi kontrollin e ushtruar në rastet kur konstatohen kundërvajtje administrative, shoqëruar me relacionin përkatës ku parashtrahet gjëndja aktuale në subjekt dhe sugjerimet për masën administrative që do të ndërmerret.

5. Regjistron të dhënat për të gjitha subjektet ku konstatohet shkelje administrative dhe ndërtim pa leje (shoqëruar me foto të objekteve në ndërtim si provë e shkeljes administrative);
6. Nëshkruan procesverbalet e konstatimit;
7. Trajton ankesat e marra nga insitucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizikë e juridik. Merr masat për zgjidhjen e tyre.

Dokumentat që aplikanti për Inspektor në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit, Sektori i Inspektimit duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 09.09.2024 **ora** 16.30.